



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Председник Општине
Belediye Başkanı



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

01 Nr. 373/24 Dt. 18.06.2024

**Procesverbali nga mbajtja e konsultimit publik me qytetarë
për Qarkoren e Pare Buxhetore 2025/1 dhe KAB-in 2025-2027, konsultimi
publik organizohet nga anëtarët e KPF-së**

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e KAB-it për vitet 2025-2027 dhe buxhetin për vitin 2025.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **04.06.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/06/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Qarkoren-e-Pare-Buxhetore-dhe-KAB-in-2025-2027-i-organizuar-nga-anetaret-e-KPF-se.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/rZtqRhAsF6SGZeBv/?mibextid=oFDknk>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42443>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-qarkoren-e-pare-buxhetore-dhe-kab-in-2025-2027-i-organizuar-nga-anetaret-e-kpf-se/>

Me 04.06.2024, njoftimi (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Konsultimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardh) dhe ka filluar në orën 11:15

Ymer Berisha, Udhëheqës i Njesisë së Komunikimit me Publikun, ka bërë hapjen e konsultimit publik, duke thënë se edhe këtë politikë kryetari komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj ka vendosur që ta bëjë sëbashku me ju, për këtë edhe jemi sot këtu që ti marrim kërkesat tuaja dhe më pas ato kërkesa, sipas mundësive buxhetore të futën në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2025/2027.

Antigona Bytyqi, kryesuese e KPF-së, ka thënë se edhe këtë vit, sikurse edhe vitet tjera po e mbajmë këtë konsultim publik duke u bazuar në statutin e komunës dhe udhëzimin administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, sigurisht që përmes këtij konsultimi ju mund t'i jepni kërkesat komentet eventuale që ju i keni.

Sulltan Badalli, drejtor për Ekonomi dhe Financa tha se për vitin 2025 buxheti i Komunës së Prizrenit sipas qarkores së parë buxhetore do të jetë:

	2024	2025	2026	2027
Granti për administratën Komunale	30,312,792	33,153,332	35,079,399	36,068,495
Granti për Arsim	19,383,401	20,247,089	20,854,502	21,480,137
Granti për Shëndetsi	6,542,493	6,981,279	7,313,588	7,661,714
Gjithsej granti nga BKK	56,238,686	60,381,700	63,247,489	65,210,346
Të hyrat vetanake nga Buxheti I KK-Prizren	10,193,294	10,600,777	11,365,866	12,148,905
Totali I buxhetit Komunal-Prizren	66,431,980	70,982,477	74,613,355	77,359,251

Kërkesat tuaja do të futen në KAB, sipas prioriteteve dhe mundësive që kemi, pasi që e kam parasysh që kërkesat janë të shumta por që mundësitë nuk janë që të gjitha kërkesat tuaja të hyn në KAB.

Kërkesat e qytetarëve:

PETRIT HOXHAI: Kryetar i fshatrave Vlashnje, Kobaj, Muradem

KOBAJ:

1. Rregullimi i infrastruktures rrugore brenda fshatit,
2. Ndriqim publik,
3. Rregullimi i trotuarit ne fshat,
4. Kubeza tek rrugacat e pa rregulluara.

MURADEM:

1. Kerkese per ndriqim publik,
2. Ndertimi i rruges malore nga fshatin Muradem e deri tek Gryka e Drinit te Bardhe- Drejtoria per Zhvillim dhe Turizem.

VLASHNJE:

1. Ndertimi i Objektivit te ri shendetesor dhe shenderrimi i saj ne QMF,
2. Ndertimi i salles se fushes se futbollit,
3. Rregullimi i infrastruktures rrugore, kanalizim, ndriqim publik tek lagjiet e reja ne fshat,

GJOK KOLNREKAJ: Perfaqesues i fshatit Karashengjergj

1. Rregullimi i infrastruktures rrugore,
2. Zgjerimi i rrugeve ne fshat,
3. Vazhdim i rregullimit te kanalizimit,
4. Rregullimi i trotuarit,

TRINGA KASEMI: Qendra per Barazi dhe Drejtesi- Shoqeria Civile ne Prizren

1. Buxhetimi gjinor,
2. Planifikimi i pese objektivave ne planin lokal veprimit per barazi gjinore,
3. Mbeshtetje financiare per kategorite sociale dhe personat me aftesi te kufizuara,
4. Kerkese per mbeshtetje financiare nga Komuna per viktimat e dhunes ne familje pasi te dalin nga strehimorja,
5. Kerkese per Strehimore te femijeve.

BUJAR PULAJ: Kryetar i fshatrave Vermice Shkoze Dobrushte

VERMICE:

1. Kerkese per ndriqimin publik,
2. Renovimi i shtepise se kultures,
3. Trotuari i rruges Vermice- Kukes.

SHKOZE:

4. Rregullimi i kanalizimit te shkolles fillore,
5. Ndriqimi publik,
6. Mirembajtje e rrjetit aktual,
7. Rregullimi I rrugicave me kubeza.

DOBRUSHTE:

1. Ndriqimi publik,
2. Te rregullohet rezervari i ujit,
3. Rregullimi i kanalizimit ne fshat,
4. Rregullimi I rrugicave me kubeza.

HEROLIND OSMANOLLAJ: Kryetar i fshatrave Tupec, Gjonaj

TUPEC-

1. Rregullimi infrastruktures rrugore,
2. Rregullimi i rruges deri tek vorrezat e fshatit,
3. Zgjerimi I rruges tek shkolla,
4. Trotuar,
5. Ndriqim publik.

GJONAJ-

1. Rregullimi i rruges kryesore,
2. Kanalizim,
3. Trotuar,
4. Kerkese per ndriqim publik.

HIL PREKPALAJ: Perfaqesues i fshatit Zym, Karashengjergj, Bregdrini

1. Te behet rregullimi Koperatives- Zyret per Keshillin e fshatrave,
2. Klubi letrar Shtjefen Gjeqovi,
3. Rregullimi infrastruktures rrugore,
4. Renovim i shtepise se policies.

EGZONA HOZHA-Anetare e Komitetit per Politike dhe Financa

1. Planifikimi i buxhetit sipas Strategjise per personat me aftesi te kufizuara,
2. Te planifikohet buxhet i veqant per transportin e femijeve me aftesi te kufizuara,
3. Sigurimi i nje muri mbrojtës tek pjesa e vorrezave te fshatit Mazrek,
4. Rregullimi infrastruktures rrugore brenda fshatit Mazrek.

EROLINA MORINA-Aktiviste e shoqerise civile

1. Te rritet numri i asistentëve neper shkolla ne qytet dhe ne fshatra (per femijet me Autizem dhe me probleme neurozhvillimore) per Drejtorine e Arsimit.

Konsultimi ka përfunduar në orën 11:55

Me 14.06.2024, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-qarkoren-e-pare-buxhetore-2025-01-dhe-kornizen-afatmesme-buxhetore-kab-2025-2027/>

Në facebook:


<https://www.facebook.com/share/p/XeBiItPWTJpdLS58/?mibextid=oFDknk>

Video e mbajtjes së konsultimit:

<https://www.facebook.com/share/v/pcQ3nvt3ddhaKKU6/?mibextid=oFDknk>

Procesmbajtës/se:

Haziz Krasniqi



Besarta Caka